

**VENDIM**  
**Nr. 259, datë 17.12.2018**

**MBI PRANIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ROBERTO OIL” SHA, PËR  
HEQJEN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË TREGTIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 5, germa “dh”, nenit 7, paragrafi 2 dhe nenit 9, germa “d”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 58, datë 18.4.2017, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Roberto OIL” sh.a. për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- ERE, me vendim të Bordit të Komisionerëve nr. 49, datë 17.4.2015, ka licencuar shoqërinë “Roberto OIL” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “Roberto OIL” sh.a., me e-mail-in e datës 13.11.2018, protokolluar në ERE, me nr. 727 prot., datë 13.11.2018, ka kërkuar revokimin e licencës pasi nuk ushtron aktivitetin tregtar, për të cilën është licencuar nga Enti Rregullator i Energjisë.

- ERE, me shkresën nr. 722/1 prot., datë 21.11.2018, i është drejtuar shoqërisë “Roberto OIL” sh.a., ku i ka kërkuar saktësimin e objektit të kërimit, duke qenë se nga përmbajtja e e-mail nuk del e qartë se cilën nga licencat kërkon të hiqet, pasi subjekti disponon dy licenca, si dhe ka kërkuar paraqitjen e vendimit të miratuar nga organet drejtuese të shoqërisë, për heqjen e licencave respektive.

- Shoqëria “Roberto OIL” sh.a. me e-mail-in e datës 3.12.2018, protokolluar në ERE me nr. 722/2 prot., datë 3.12.2018, ka përcjellë vendimin nr. 5 prot., datë 9.11.2018, e ortakut të vetëm të shoqërisë, për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 278, seria T15, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 49, datë 17.4.2015.

- Shoqëria “Roberto OIL” sh.a. ka kryer pagesën e rregullimit, për vitet 2015, 2016, 2017, në pajtim me pikën 3.8 të kushteve të licencës, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Kërkesa për heqjen e licencës sipërcituar, vjen si rezultat i mos ushtrimit të veprimtarisë, për të cilën është licencuar shoqëria “Roberto OIL” sh.a. dhe i drejtohet ERE-s nën vullnetin e saj të plotë.

- Kërkesa e shoqërisë “Roberto OIL” sh.a., për heqjen e licencave së tregtimit vjen në zbatim të nenit 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në të cilin citohet se: *ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit*, si dhe nenit 5, germa “dh”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 58, datë 18.4.2017, të Bordit të ERE-s.

- Po ashtu në paragrafin 2, të nenit 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, përcaktohet se: *“Në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje”*.

- Neni 9 “Vendimet e Bordit”, i kësaj rregullore në germën “d” të saj, përcakton se: *“...Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7, paragrafi 2, të kësaj rregulloreje.”*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Roberto OIL” sh.a., për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 278, seria T15, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 49, datë 17.4.2015.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar humbet fuqinë e saj juridike.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Petrit Ahmeti**